VENDIM
Nr. 55, datë 28.8.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT"

Kjo rregullore nxirret në bazë e për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe 43 shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të nenit 9 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të neneve 7, 11, 24 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" dhe të nenit 27 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit".

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në rregulloren "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", miratuar me vendimin nr. 44, datë 10.6.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si më poshtë vijon:

a) Në fund të pikës 2 të nenit 5 të rregullores, shtohet fjala "i ndryshuar";

b) Neni 6 i rregullores ndryshohet si më poshtë vijon:

i) titulli i nenit 6 ndryshohet me përmbajtje si vijon:

"Masat parandaluese të ndërmarra nga subjektet".

ii) pikat 1 dhe 2 të nenit 6 ndryshohen me përmbajtje si vijon:

"1. Subjektet marrin masat e "vigjilencës së duhur" dhe "vigjilencës së zgjeruar" në rastet e përcaktuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe zbatojnë masat e identifikimit dhe verifikimit të klientëve sipas kërkesave të parashikuara në këtë ligj dhe në dispozitat e kësaj rregulloreje;

2. Subjektet hartojnë politika, udhëzime apo procedura të brendshme për pranimin, identifikimin, regjistrimin, monitorimin, administrimin e rrezikut, si dhe raportimin e transaksioneve të klientëve, në përputhje me nenin 2, pika 21, si dhe nenin 11 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.";

iii) në fund të pikës 5 të nenit 6 shtohet një paragraf me përmbajtje si vijon:

"Subjektet miratojnë dhe zbatojnë procedura specifike të administrimit të rrezikut, në rastet e transaksioneve apo marrëdhëniet e biznesit, të kryera pa praninë fizike të klientit.";

iv) në pikën 7 të nenit 6, pas togfjalëshit "Për masat kundër financimit të terrorizmit", shtohet togfjalëshi "dhe akteve ligjore të nxjerra në zbatim të tij";

v) pika 8 e nenit 6 ndryshohet me përmbajtje si vijon:

"Subjektet refuzojnë hapjen e llogarisë së klientit, kryerjen e transaksioneve dhe nuk hyjnë në marrëdhënie biznesi me të, në rast se nuk plotësohen kërkesat për identifikimin e tij dhe kërkesat e vigjilencës së duhur të parashikuar në kreun III të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.".

c) Neni 8 i rregullores ndryshohet si më poshtë vijon:

i) pika 2 e nenit 8 ndryshohet me përmbajtje si vijon:

"Subjektet caktojnë një person përgjegjës, në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Personat përgjegjës kanë akses të vazhdueshëm ndaj të gjitha të dhënave dhe në çdo lloj informacioni që disponohet nga subjekti, i cili është i nevojshëm për përmbushjen e detyrave.";

ii) pika 6 e nenit 8, rinumërohet dhe bëhet pika 3;

iii) pika 3 e nenit 8, rinumërohet dhe bëhet pika 4;

iv) pika 4 e nenit 8, rinumërohet dhe bëhet pikat 5, si dhe ndryshohet me përmbajtje si vijon:

"Subjektet i vënë në dispozicion Bankës së Shqipërisë, menjëherë pas miratimit të tyre, kopje të procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, të

parashikuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.”;

v) pika 5 e nenit 8, rinumërohet dhe bëhet pikat 6, si dhe ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“Subjektet hartojnë dhe miratojnë rregullore/procedura për vlerësimin dhe kategorizimin e klientëve apo transaksioneve sipas shkallës së rrezikut që ato paraqesin, në përputhje me nenet 8 dhe 9 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

Përveç kategorive të parashikuara në nenet 8 dhe 9 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave, subjektet mund të përcaktojnë edhe kategori të tjera rreziku, duke iu referuar udhëzuesit “Për vlerësimin e rrezikut mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit” bashkëlidhur kësaj rregulloreje.”;

vi) Pas pikës 7 të nenit 8, shtohet pika 8 me përmbajtje si vijon:

“Subjektet sigurohen se filialet, degët, si dhe agjencitë e tyre, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe, në veçanti, në vendet dhe territoret, të cilat nuk zbatojnë apo zbatojnë pjesërisht standardet ndërkombëtare, veprojnë në përputhje me masat parandaluese të parashikuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave. Në qoftë se masat parandaluese në vendet ku janë këto filiale, degë, si dhe agjencitë e tyre ndryshojnë, atëherë subjektet duhet të sigurohen që kanë përparësi detyrimet më të larta. Nëse ligjet e vendit, ku janë vendosur filialet, degët ose agjencitë, parashikojnë pengesa për zbatimin e detyrimeve, subjekti duhet të raportojë për këto pengesa tek autoriteti përgjegjës dhe sipas rastit dhe në Bankën e Shqipërisë.”;

vii) pikat 8, 9, 10, 11, 12 të nenit 8, rinumërohen dhe bëhen pikat 9, 10, 11, 12, 13.

d) Neni 9 ndryshohet si më poshtë vijon:

i) shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve;”;

ii) shkronja “b” e pikës 1 shfuqizohet;

iii) në pikën 2 togfjalëshi “mund të përfshijë pastrim parash ose financim terrorizmi”, zëvendësohet me togfjalëshin “mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale”;

iv) pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me përmbajtje si vijon:

“4. Subjektet, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transferta parash ose vlerash, duhet të mbajnë një listë të agjentëve që operojnë për llogari të tyre. Këta agjentë do të konsiderohen si pjesë e subjektit, i cili duhet t’i trajnojë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe të sigurohet që ata zbatojnë të njëjtat masa të vigjilencës së duhur ndaj klientit, mbajtjes së të dhënave dhe raportimit.

5. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.”.

e) Në nenin 10, pas pikës 5, shtohet pika 6 me përmbajtje si vijon:

“Banka e Shqipërisë mund të kërkojë nga subjektet akses dhe vënien në dispozicion të çdolloj informacioni dhe dokumenti që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të subjekteve në zbatim të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.”.

f) Pas nenit 11, aneksi I dhe II i rregullores shfuqizohet dhe miratohet aneksi nr. 1, i cili përmban udhëzuesin “Për vlerësimin e rrezikut mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit”, si dhe aneksi nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani